



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 05
26 janar – 1 shkurt 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	11 / 11	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	6 / 7	86%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

		Pukë	9 / 11	82%
	Kukës	Kukës	13 / 14	93%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	5 / 6	83%
VLOREË	Vlorë	Vlorë	21 / 21	100%
		Sarandë	9 / 10	90%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	9 / 9	100%
	Gjirokastër	Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	423 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 05

	JAVA 05
Diarre pa gjak	1183
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. të sipërme	11990
Inf. Resp. të poshtme	5313
Rash me temperaturë	20
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	423
% e Njësive Raportuese	99% (423/429)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 6 raste



Fier– 1 rast

Pogradec– 1 rast



Vlorë– 2 raste

Durrës– 6 raste

Sarandë– 4 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grupmoshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 05 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 04.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa gjak sipas javëve**Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa gjak sipas grup-moshave**


Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ulje në javën 05 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 04.

Grafiku 5. Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 05 krahasuar me javën paraardhëse, java 04 duke mbetur brenda kufijve të aktivitetit sezonal normal.

Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 45 – 05 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 05 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.


Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 04/2026 dhe 05/ 2026. Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, lidhur me përhapjen e gripit në vend. Aktiviteti i gripit këtë javë është në ulje, por i përhapur në të gjithë territorin e vendit.

Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 04-05 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve

Në javën 05 vërehet prirje në ulje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i ulët i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 04-05/2026 Incidenca (raste/10.000).

Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Kolonjë, Tepelenë, Mirditë, Mallakastër, ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Bacillus cereus në formulën për foshnje

- Një tërheqje nga tregu në shumë vende e disa produkteve të ushqyerjes për foshnje (seri, produkte dhe marka të ndryshme) u iniciua pas zbulimit të cereulidit, toksinës emetike të prodhuar nga *Bacillus cereus*.
- Tërheqja paraprake u iniciua në dhjetor 2025 dhe është ende në vazhdim në janar 2026 si një masë parandaluese për të mbrojtur shëndetin publik. Analiza e shkakut rrënjësor e ndërmarrë nga kompania identifikoi përbërësin (vaji i acidit arakidonik (ARA)) që çoi në ngjarjen e kontaminimit.
- ECDC ka marrë disa raporte për raste të diarresë të foshnjat, dhe një rast të konfirmuar që lidhet me zbulimin e toksinës *B. cereus*.

Antitruapat kundër gripit të shpendëve A(H5N1) në bagëti – Holanda – 2026

- Autoritetet në Holandë raportojnë se antitruapat kundër gripit të shpendëve A(H5N1) janë zbuluar në qumështin e një lope në një fermë qumështi në Friesland.
- Ky është zbulimi i parë i tillë te bagëtia në BE/EEA dhe jashtë Shteteve të Bashkuara, ku gripi i shpendëve u zbulua për herë të parë te bagëtia në mars të vitit 2024.
- Njerëzve në fermë dhe një veterineri u është ofruar testim (PCR dhe serologji) dhe rezultatet janë në pritje.

Sëmundja e virusit Nipah - Indi - 2026

- Sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies së Familjes (MoHFW) të Indisë më 27 janar 2026, ka pasur dy raste të konfirmuara të Virusit Nipah (NiV) të raportuara në shtetin e Bengalit Perëndimor.
- Disa media duke cituar autoritetet shëndetësore të Indisë, kanë raportuar pesë raste të sëmundjes Nipah në distriktin e Parganas Veriore 24, në shtetin e Bengalit Perëndimor.
- Të dy rastet e konfirmuara janë punonjës të kujdesit shëndetësor në të njëjtin spital, sipas raportimeve të medias.
- Që nga 27 janari 2026, gjithsej 196 kontakte të rasteve të konfirmuara u identifikuan dhe rezultuan negativë për NiV, sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies së Familjes (MoHFW).
- Tailanda, Nepali, Kamboxhia dhe vende të tjera fqinje kanë filluar masa, duke përfshirë fushata informuese dhe kontroll për pasagjerët që vijnë nga India në aeroporte.
- Mundësia e ekspozimit dhe infeksionit me NiV për qytetarët tone që udhëtojnë ose banojnë në Indi është aktualisht shumë e ulët, duke pasur parasysh numrin e ulët të infeksioneve në zonat ku janë identifikuar raste deri më sot.

Sëmundja e virusit Marburg (MVD) – Etiopi – 2025/26

- Më 26 janar 2026, Ministria e Shëndetësisë e Etiopisë shpalli fundin e shpërthimit të sëmundjes së virusit Marburg (MVD) në vend.
- Numërimi mbrapsht prej 42 ditësh për shpalljen e përfundimit të shpërthimit filloi më 14 dhjetor 2025, pas vdekjes së pacientit të fundit të konfirmuar me MVD.
- Që nga shpallja e shpërthimit më 14 nëntor 2025, u raportuan gjithsej 19 raste (14 të konfirmuara dhe pesë të mundshme) të MVD, duke përfshirë 14 vdekje (nëntë të konfirmuara dhe pesë të mundshme; shkalla e vdekshmërisë së rasteve (CFR): 64.3%).
- Rastet u raportuan në katër woredas (zona) në dy rajone: Jinka, Malle dhe Dasenech në Shtetin Rajonal të Etiopisë Jugore, dhe Hawassa në Rajonin Sidama.

- Ky ishte shpërthimi i parë i MVD i raportuar ndonjëherë në Etiopi.
- Rreziku i përgjithshëm për banorët e BE-së/EEA-së që vizitojnë ose jetojnë në Etiopi u vlerësua si i ulët.

Kolera – Shumëvendëshe (Bota) – Monitorimi i shpërthimeve globale

- Që nga 1 janari 2026 dhe deri më 27 janar 2026, 1 203 raste të kolerës, përfshirë shtatë vdekje, janë raportuar në gjashtë vende (Angola, Malavi, Mozambik, Namibi, Somali dhe Zambia). Nuk ka të dhëna të disponueshme për rastet e raportuara në vende të tjera në vitin 2026.
- Që nga 24 dhjetori 2025 dhe deri më 28 janar 2026, 11 965 raste të reja të kolerës, përfshirë 126 vdekje të reja, janë raportuar në të gjithë botën.
- Pesë vendet që raportojnë më shumë raste janë: Republika Demokratike e Kongos (4 522), Afganistani (3 029), Jemeni (1 144), Mozambiku (896) dhe India (878).
- Pesë vendet që raportojnë numrin më të madh të vdekjeve të reja janë: Republika Demokratike e Kongos (89), Filipinet (14), India (6), Jemeni (5) dhe Bregu i Fildishtë (4).
- Rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në Afrikë dhe Azi, Lindjen e Mesme dhe Amerikë. Rreziku i infeksionit me kolerë tek udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, edhe pse importimi sporadik i rasteve në BE/EEA është i mundur.